

Sekretari Këshillit Bashkia

Prob. 10757/3
26.08.01.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Durrës, më 05/01/2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
KRËJË**


**KRYETARIT TË BASHKISË
KRËJË**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Krujë Nr.66 dt.23.12.2025, "Për miratimin e caktimit të nivelit të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Krujë për vitin 2026".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË
KËSHILLI BASHKISË KRUJE

Krujë Qendër, Sheshi Skënderbej, tel. 051122170, e-mail: infokruja@gov.al

VENDIM

Nr. 66 datë 23.12.2025

**“PËR CAKTIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE NË
BASHKINË KRUJË PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenit 98 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr. 273, datë 16.5.2018 "Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" (kadastra fiskale)", VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 i MF "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Keshilli Bashkiak .

V E N D O S I :

1. Miratimin e caktimit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Krujë gjatë vitit 2026 sipas aneksit nr.1 bashkelidhur këtij akti.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit , Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Sherbimeve dhe Investimeve Publike Drejtoria e Juridike dhe e Prokurimit Publik , Njësitë Administrative perberese te Bashkise Kruje , të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë që janë objekt i parashikimeve të

këtij vendimi si dhe Drejtoritë e Institucionet përgjegjëse, të cilat kanë role dhe përgjegjësi specifike të përcaktuara në planin e taksave dhe tarifave vendore

- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, të ndryshuar dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2025.

KRYETARI I KESHILLIT

Viktore TOTRI



Shpallur sot më datë 23 .12 .2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUIJË
KRYETARI

Krujë Qendër, Sheshi Skënderbej, tel. 051122170, e-mail: infokruja@gov.al

PROJEKT -VENDIM

Nr. 66 datë 23.12 2025

**"PËR CAKTIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE NË
BASHKINË KRUIJË PËR VITIN 2026"**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenit 98 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligji Nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr. 273, datë 16.5.2018 "Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" (kadastra fiskale)", VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 i MF "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë propozon Keshillit Bashkiak që të:

V E N D O S I :

- 1.Miratimin e caktimit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Krujë gjatë vitit 2026 sipas aneksit nr.1 bashkelidhur këtij akti.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit , Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Sherbimeve dhe Investimeve Publike Drejtoria e Juridike dhe e Prokurimit Publik , Njësitë Administrative perberese te Bashkise Kruje , të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet e varësisë që janë objekt i parashikimeve të këtij vendimi si dhe Drejtoritë e Institucionet përgjegjëse, të cilat kanë role dhe përgjegjësi specifike të përcaktuara në planin e taksave dhe tarifave vendore

- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës, të ndryshuar dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2025.

Per Drejtorine e Taksave dhe Tarifave Vendore

Lindita Taçi

Per DPZHT

Ergys Sallaku

Per Drejtorine e Financave dhe Buxhetin

Esat Farruku

Per Drejtorine e Sherbimeve dhe Investimeve Publike

Edi Salaj

Per Drejtorine Juridike

Genc Halili

KRYETARI I BASHKISË

Artur BUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KRUIJË
Drejtoria Tatim -Taksave

Nr. / prot

Kruje me 23 /12/2025

RELACION : KËSHILLIT BASHKIAK KRUIJË

Lenda : Mbi caktimin e nivelit te taksave e tarifave vendore per vitin 2026

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 139/2015 "Per vet qeverisjen vendore" , ligji 68/2017 "Per financat e qeverisjes vendore", ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, VKM nr 144, date 13.02.2020 dhe VKM 457 date 26.07.2023 "Per disa ndryshime ne VKM nr 132, date 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa"..., Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 20.6.2022 për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore ,Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Ligji nr. 9975 date 28.07.2008 "Per taksat kombetare" i ndryshuar, Ligji nr.8308 date 18.03.1998 "Per transportin rrugor" I perditesuar, Ligji nr 107/2014, "Per Planifikimin e territorit" VKM 408 date 13.05.2015 "Per miratimin e zhvillimit te territorit" I ndryshuar, VKM nr 460, date 22.05.2013 "Per percaktimin e kritereve rregullave dhe procedurave te dhenjes me qera te tokave bujqesore ne pronesi te shtetit, ligjit nr 57/2020 . "Per pyjet ", VKM 684 date 02.09.2020 "Per disa shtesa e ndryshime ne vendimin nr 433 date 08.06.2015, VKM nr 559 date 29.07.2022 , Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenjen ne shfrytzim/perdorim te fondit pyjor kombetar, per veprimtari ekonomike si dhe per prodhime drusore dhe jo drusore pyjore. VKM nr.54, date 05.02.2014 "Per përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar ligjit 152 dt 21.12.2015 " Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi" dhe Vendimit 285, date 27.06.2002. " Per tarifate sherbimeve qe kryen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ndaj shtetasve dhe personave, juridike e fizike, vendas e te huaj" ,ligjit 10463 date 22.09.2011 , Per manaxhimin e integruar te mbetjeve urbane " i ndryshuar , ligjit nr 10279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", Ligjit Nr 24 date

09.03.2017 "Per administrimin e ujitjes dhe te kullimit",legjislacionit te aplikueshem ne fuqi, akteve nenligjore te miratuara.

Keshilli Bashkiak percakton ushtrimin e te drejtave te administrimit dhe vendosjes se taksave dhe tarifave qe do te aplikohen gjate vitit ushtrimor.Ne ligj jane percaktuar nivele orientuse te taksave por shuma faktike e tatimit per tu paguar per cdo kategori biznesi vendoset nga organi legjislativ, Keshilli i Bashkise . Keshilli i Bashkise mund te ndryshoje nivelin tregues te taksas , duke e rritur ose e pakesuar ate. Duke u mbeshtetur ne ligjet qe cituam me siper dhe planet e te ardhurave te grumbulluara nga vitet e meparshme si dhe ne mbeshtetje te vitit ushtrimor 2025, relaton si me poshte, grupi i punes i ngritur me Urdher nr 513 date 11.11.2025, per kete qellim nga ana e Kryetarit te Bashkise Kruje z. Artur Bushi perbere nga Zoterinjte :

-Yllka	kukalaj	Z.V/Kyetar i Bashkisë	Kryetar
-Lindita	Taçi	Drejtoe e Taksave dhe Tarif. Vendore	Z.V/Kryetar
-Hamdi	Zaja	Drejtor Kabineti	Anëtar
-Sabije	Seseri	Drejtor Burimeve Njerëzore,	Anëtar
-Genc	Halili	Drejtoe Juridike&Prokurimeve	Anëtare
-Esat	Farruku	Drejtor i Financës	Anëtar
-Ergys	Sallaku	Drejtor PKZHT	Anëtar
-Erisa	Daci	Drejtoe MTP	Anëtare
-Ilira	Suta	Drejtoe Shërbimit Social	Anëtare
-Elis	Hysa	Drejtor A-K-S	Anëtar
-Edi	Salaj	Drejtor i Sherbimeve	Anëtar
-Xhavit	Mullahi	Përgjegjës SMC	Anëtar
-Agron	Stafuka	K/Inspektor IMTV	Anëtar
-Artan	Gjergji	Përgjegjës Sektori i Mir.Rrugeve	Anëtar
-Fehmi	Mahmutaj	Përgjegjës Sektori i Pyjeve	Anëtar
-Klodian	Laska	Pergjegjes Bordi Kullimit	Anëtar

HYRJE

Paketa fiskale përcakton nivelin e taksave dhe të tarifave vendore, sipas llojeve të tyre, bazën tatimore, kategorizimet dhe nenkategorizimet e taksave, mënyrën e administrimit dhe të mbledhjes së tyre, kushtet lehtësuese, si dhe strukturat e ngarkuara për vjeljen e tyre, përfaqësimin dhe legjislacionin në fuqi i njoh diskrecionin Bashkisë Krujë.

I- TAKSAT VENDORE

Llojet e taksave vendore janë të përcaktuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Diskrecioni i Bashkisë Krujë për administrimin e shtimit të taksave dhe tarifave vendore, përcaktohet nëpërmjet legjislacionit në fuqi, ku si baza shërben:

- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.
- Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligji nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Aktet nenligjore për zbatimin e ligjeve të mesipërme
- Çdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor në fuqi, përfaqësimin dhe funksionet e Bashkisë Krujë për administrimin e të ardhurave vendore.

LLOJET E TAKSAVE VENDORE, BAZA E TAKSIMIT, KATEGORIZIMET DHE NENKATEGORIZIMET SHËRBËNËRËT E ADMINISTRIMIT TATIMOR

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kushtet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese dhe agjenti tatimor.

I. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

1. Taksën mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokument pronësie.

2. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten ligjit "Për sistemin e taksave vendore" dhe janë pjesë përbërëse e tij,

2.2 Referuar ligji 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", pika 5, neni 12 "Rregulla të përbashkëta për taksat vendore" Për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 për qind dhe minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

“Ndertesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

“Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

“Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

“Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

“Ndertesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

“Përdorues”, individi, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo

“Taksapagues”, çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave.

“Veprimtari ekonomike”, çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

“Vlerë e pasurisë”, vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji.

- **Detyrimi për taksën mbi ndërtesat** llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- **Baza e taksës** mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 132 , date 07.03.2018, aneksi 1dhe 2 pjesë e këtij vkm,ndryshuar me VKM 144.date 13.02.2020.
- **Vlera e pasurisë** është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore.
- **Vlera e pasurisë llogaritet** si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

1-Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore .

Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet

mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar.

Vetëdeklarimi

- 1.1 Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ASHK) Për përcaktimin e bazës së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, si referencë, në këtë rast, do të shërbejë vlera e përcaktuar nga rivlerësimi i pasurisë të regjistruar pranë ASHK-ve. Nëse në informacionin e marrë nga ASHK-ja konstatohet se për ndërtesën/njësinë pronësore është kryer një transaksion shitblerjeje gjatë 3 viteve të fundit, atëherë si bazë e taksueshme do të merret vlera më e lartë midis transaksionit dhe vlerës të regjistruar në ASHK

- 1.2 .3 Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/njësive pronësore Kur vlerësimi sipas pikave 1.1 dhe 1.2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të përcaktuara në aneksin 1 që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 1.3 Për nënkategorizime të ndërtesave, që nuk shërbejnë për banim, sipas qëllimit të përdorimit, zbatohen çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi, të përcaktuara në aneksin 2 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Nëse çmimi për metër katror për banesë/njësi pronësore, i vënë në dispozicion nga ASHK-ja, dhe çmimet minimale fiskale janë të ndryshme, atëherë merret si çmim vlerësues ai çmim që ka vlerën më të lartë.
- 1.4 Nëse çmimi për metër katror për banesë/njësi pronësore, i vënë në dispozicion nga ASHK-ja, dhe çmimet minimale fiskale janë të ndryshme, atëherë merret si çmim vlerësues ai çmim që ka vlerën më të lartë.

2. Vlera e pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", referuar verifikimeve në terren

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektimet kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore. Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njesisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren.

2.1 Sipërfaqja e prezumuar :

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

2.2 Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

3. Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit

Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësitë përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm

Siperfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK).

Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesi, Zyrat e Taksave të Bashkisë, për vërtetimin e pronës njohin:

- a) vendimet e komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronës
- b) vendimet e privatizimit
- c) dokumentat e tjera të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore në përputhje me legjislacionin përkatës.

Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave

-Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose komune, pavarësisht nga vendbanimi i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë me vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

- A. Taksa mbi ndërtesën.**
- B. Taksa mbi tokën bujqësore**
- C. Taksa mbi truallin**

A TAKSA MBI NDERTESAT

- 1) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
- 2) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
- 3) Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- 4) Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit. Në rast kur ndërtesa përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore, të parashikuara për t'u përdorur për qëllime të ndryshme apo për t'u tjetërsuar në pronësi të më shumë se një pronari/përdoruesi, si bazë e taksës do të shërbejë kostoja e plotë e ndërtimit të të gjitha njërive përbërëse të ndërtesës, pavarësisht fazës në të cilën gjendet e gjithë ndërtesa e papërfunduar. Në qoftë se njësitë e ndërtesës, bazuar në lejen e miratuar të ndërtimit, janë parashikuar për qëllime të ndryshme përdorimi (për shembull, disa për banim dhe disa për veprimtari ekonomike/joekonomike), vlera e pasurisë së paluajtshme për përcaktimin e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës së përcaktuar me ligj, sipas llojit të përdorimit, shumëzuar me koston e ndërtimit për njësi të ndërtesës. Në rast se zhvilluesit kanë lidhur kontratë shitjeje për tjetërsimin e pronësisë së ndërtesës së papërfunduar apo të njërive të veçanta të saj, si bazë e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, për efekt të llogaritjes së taksës së ndërtesës, do të shërbejnë kontratat e shitjes. Në qoftë se nga krahasimi rezulton se vlera e kontratave të shitjes është e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmimin vlerësues, atëherë si bazë e taksës përcaktohet vlera më e lartë. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me koston e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Në të gjitha rastet e përmendura në piken 3, personi që ka për detyrim pagesën e taksës së llogaritur është zhvilluesi. Në rastin kur njësi të veçanta të ndërtesës janë vënë në përdorim dhe taksa paguhet e plotë, paguesi i taksës së llogaritur është përdoruesi.

Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj si më poshtë;

❖ **Tabela2: Shkalla e taksës në % për çdo kategori ndërtimi**

Kategoritë dhe nënkategoritë	% e shkallës së taksës
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim	0.05%
Për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	0.20%
-Për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.	30% e shkallës së taksës përkatëse

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nëndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda

juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind.

4 Ndarja zonale dhe nenzonale e territorit që do të përdoret për zbatimin e niveleve plus/ minus të shkallës së taksës vetëm për ndërtesat e banimit.

Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësisive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Nivelet e miratuara sipas zonave/nënzonave të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore i bëhen të ditura zyrtarisht edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë.

❖ **Tabela 3: Ndarja zonale dhe nenzonale e territorit që do të përdoret për zbatimin e niveleve plus/ minus të shkallës së taksës vetëm për ndërtesat e banimit.**

Ndarje zonale		Nen/ndarje te zones I			Nen/ndarje zona II		
Zona 1	Zona2	1-A	1-B	1-C	2-A	2-B	2-C
Nj/Ad Kruje Nj/Ad F- Kruje	Nj/Ad. Cudhi, Nikel, Bubq Thumane	Qytet: Kruje, F.Kruje e	Fshat F.kruje Halil,Zalle, Arramerras1.2 Larushk 1.2, Luz1.2, Hasan	Te gjithë fshatrat e tjere te Zones 1	Nikel, Bubq, Thumane	Tapize, Qereke, Rinas, Koder Thumane Borizane, Bushnesh	Nj/Ad Cudhi, Te gjithë fshatrat e tjere qe nuk jane te perfshire ne 2-A,2-B.

❖ **Tabela 4: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për qëllime banimor referuar aneksit 1, të VKM 132, datë 07.03.2018 që do të përdoren për llogaritjen e vlerës së pasurisë, sipas njësive.**

	Bashkia Kruje	Cmimi mesatar referues/m2
1	Njesia Administrative Kruje	48.500 lek/m2

2	Njesia Administrative Fushe- Kruje	51.000 leke/m2
3	Njesia Administrative Nikel	51.000 leke/m2
4	Njesia Administrative Bubq	51.000 leke/m2
5	Njesia Administrative Thumane	51.000 leke/m2
6	Njesia Administrative Cudhi	48.500 leke/m2

A.Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

1. Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

B.Nënkategorizimi i ndërtesave/njësive pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, bashkëngjitur vendimit nr 132 date 07.03.2018 ndryshuar me VKM nr 144 date 13.02.2020.

Propozojme keshillit bashkiak te vendose per nivelin tregues te shkalles se taksës si:
 Ndërtesat e banimit te përfshira në Nen/ndarje te zones I ,I-A propozojme : ulje te nivelit baze i shkallës së taksës (minus 10%)
 Ndërtesat e banimit te përfshira në Nen/ndarje te zones I, II ,I-B,II-A propozojme: ulje te nivelit baze i shkallës së taksës(minus 15%)
 Ndërtesat e banimit te përfshira në Nen/ndarje te zones I, II ,I-C, II-B dhe te gjitha nënkategoritë e tjera te ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim propozojme: ulje te nivelit baze i shkallës së taksës(minus 20%),
 Ndërtesat e banimit te përfshira në Nen/ndarje te zones II, II-C propozojme : ulje te nivelit baze i shkallës së taksës(minus 30%)

Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së pare

Ndërtesat/njësi pronësore që nuk përdoren për banim,dhe te gjitha nenkategorizimet sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre,te percaktuara ne aneksin 2 te VKM nr 132 date 07.03.2018, ndryshuar me VKM nr 144 date 13.02.2020. pika a,b,c,ç, propozojme : niveli baze I shkalles se taksës te rritet (plus 30%).

Ndërtesat/njësi pronësore që nuk përdoren për banim,dhe te gjitha nenkategorizimet sipas qëllimit të përdorimit, por ne fakt sipas verifikimit ne terren nuk perdoren/ shfrytezohen per asnje qellim , do te klasifikohen sipas pikes ç, te percaktuara ne aneksin 2 te VKM nr 132 date 07.03.2018 te ndryshuar.

❖ **Tabela 5 : Nënkatëgorizimi i ndërtesave/njësi pronësore sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre , cmimi për m2 sipas nivelit të cmimit referues, referuar ankseve 1,2 të VKM 132, të ndryshuar me VKM nr 144 datë 13.02.2020.**

Nr	Nënkatëgorizimi ndërtesave/njësi pronësore	Niveli cmimi referues	Cmimi referues për kategori sipas qyteteve		Shkalla në përqindjes të takses (100%)
			Qyteti referues	Vlera pasurisë lek/m2	
1	Ndërtesa banimi në pronësi apo përdorim.				
1	Ndërtesa banimi	100% e cmimit të banesave	Kruje	48500	0.05%
			Nj/adm Cudhi		
			Nj/adm	51000	0.05%
			F-Kruje Thumane Nikel Bubq		
2	Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992	70% e cmimit të banesave	Kruja	33950	0.05%
			Nj/adm Cudhi		
			Nj/adm	35700	0.05%
			F-Kruje Thumane Nikel Bubq		
3	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	100% e cmimit të banesave	Kruje	48500	0.05%
			Nj/adm Cudhi		

				Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	51000	0.05%
II	Ndërtesa të tjera në pronësi apo përdorim që nuk shërbejnë për banim.					
1	Ndërtesa për veprimtari tregtare, shërbimi, procese të perziera,	150% cmimit baneses	e te	Kruje NJ/adm Cudhi	72750	0.2%
				Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	76500	0.2%
2	Per parkime te mbuluar dhe bodrume, etj	70% cmimit baneses	e te	Kruje NJ/adm Cudhi	33950	0.2%
				Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	35700	0.2%
3	Per parkime te hapura, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, etj	30% cmimit baneses	e	Kruje NJ/adm Cudhi	14550	0.2%
				Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	15300	0.2%
4	Per veprimtari industrial, etj.	50% cmimit	e te	Kruje NJ/adm Cudhi	24250	0.2%

		baneses	Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	25500	0.2%
5	Per veprimtari bujqesore dhe blektorale,etj	30% e cmimit te baneses	Kruje NJ/adm Cudhi Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	14550 15300	0.2% 0.2%
6	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimi të hipotekuara si ndërtesa jo per banim.	Ne % sipas llojit te percaktimeve te mesiperme e baneses	Kruje NJ/adm Cudhi Nj/adm F-Kruje Thumane Nikel Bubq	72750 76500	0.2% 0.2%
	Ndërtesa të pajisura me leje per banim, te paperfunduara, ne shkelje te afatit te lejes se ndertimit	Kosto e ndertimit		47454	30% e 0.05%
7	Ndërtesa të pajisura me leje jo per banim, te paperfunduara, te paperfunduara, ne shkelje te afatit te lejes se ndertimit	Kosto e ndertimit		47454	30% e 0.2%

Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë:

- Të dhënat e vetëdeklaruar nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi/përdorim të tij;
- Të dhënat e disponuara nga ASHK-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;

- c) Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;
- ç) Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;
- d) Të dhënat e ALUIZNI-t për ndërtesat në proces legalizimi;
- dh) Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;
- ë) Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtese, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;
- f) Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.

➤ Mënyra dhe afatet e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

-Për katëgorinë **Ndërtesa banimi, pagesa bëhet brenda datës 30 Dhjetor të vitit ushtrimor.**

- Për katëgorinë **(Ndërtesa të tjera që përdoren për qëllime biznesi).**

Afati i pagesës: Pagesa e detyrimit mbi taksën e pasurisë do të behet me dy keste:

-kesti i pare 30 qershor 2026,

-kesti i dyte 30 tetor 2026 - per te gjithë subjektet qe pajisen me njoftim vlersim per detyrimet tatimore e njoftuara para dates 30 .05.2026

Për Vlersimet tatimore te derguara pas dates 30.05.2026, afati i pagesës kesti i pare: është 30 ditë pas marrjes dijeni te detyrimit, kesti i dyte 31.12.2026

Detyrimet e lindura per efekt të përditësimit te të dhënave ne regjistrin qendror të pasurive të paluajtshme (kadastra fiskale) siç e parashikon ligji, do tju njoftohen ne nje moment te dyte. Pastaj do bëhet rakordimi i pagesave +/- për diferencën.

Drejtoria e Tatim Taksave Vendore nuk do te pajise me vertetim per shlyerje detyrimesh taksapaguesit, subjekte, personin fizik apo juridik, nese nuk eshte likujduar edhe detyrimi mbi ndërtesen/njesine pronesore ku ushtron aktivitet subjekti , pavarësisht pronësisë së objektit.

Perjashtimet nga taksa mbi ndërtesen

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;

f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Perjashtohen dhe Lehtësohen nga taksat :

1.1- Lidhur me zbatimin e taksës së ndërtesës për kategoritë e ndërtesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të vlerësuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të Programit të Rindërtimit të dëmeve të tërmetit, të mos taksohen ndërtesat për qëllime banimi për kategoritë e dëmtimit të klasifikuara në shkallën e dëmtimit si më poshtë:

1.2.1 Per familjaret ,pasuria e te cileve eshte demtuar (nuk ekziston/vendim per shembje) nga tërmeti sipas akt kostatimet te leshuar nga komisioni, i vleresuar me shkallen e demtimit DS4,DS5.

1.2.2 Per familjaret ,pasuria e te cileve eshte demtuar nga tërmeti, sipas akt kostatimet te leshuar nga komisioni,dhe i vlersuar me shkallen e demtimit DS1,DS2,DS3, per periudhen qe trajtohen me bonus qeraje nga Bashkia Kruje.

2.1 Reduktimin e çmimit vlerësues të vlerësuar për zonën përkatëse për ndërtimet e klasifikuara sipas kategorive të Aneksit 2 të VKM, për qëllim taksimi për ndërtimet për qëllime veprimtarie ekonomike, shkalla e dëmtimit të të cilave është vlerësuar si më poshtë:

2.2 Reduktimi me 5 % i çmimit, kur ndërtesa është demtuar nga tërmeti, sipas akt kostatimit te leshuar nga Instituti i Ndertimit/te tjera organe ,studio, te licensuara nga shteti shqiptar,vlersuar me shkallen e demtimit DS1, DS2.

2.3 Reduktimi me 15 % i çmimit, kur ndërtesa është demtuar nga tërmeti,sipas akt kostatimit te leshuar nga Instituti i Ndertimit/te tjera organe ,studio, te licensuara nga shteti shqiptar,te vlersuar me shkallen e demtimit DS3.

2.4 Reduktimi me 50 % i çmimit, kur ndërtesa është demtuar nga tërmeti, sipas akt kostatimit te leshuar nga Instituti i Ndertimit/te tjera organe ,studio, te licensuara nga shteti shqiptar,te vlersuar me shkallen e demtimit DS4.

2.5 Reduktimi me 75% i çmimit, kur ndërtesa është demtuar nga tërmeti,sipas akt kostatimit te leshuar nga Instituti i Ndertimit/te tjera organe ,studio, te licensuara nga shteti shqiptar,te vlersuar me shkallen e demtimit DS5.

Këto lehtësira zbatohen deri në momentin e kthimit të ndërtesës në gjendje të plotë shfrytëzimi, në kuadër të zbatimit të Programit të Rindërtimit.

Në rast se stuktura e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Krujë konstaton se këto ndërtesa janë vënë në shfrytëzim plotësisht ose pjesërisht përpara afatit të dhënë në lejen e zhvillimit, apo pa u pajisur më parë me leje zhvillimi, taksat llogaritet e plotë, duke nisur që nga momenti i vënies në shfrytëzim, sipas përcaktimeve në dispozitat përkatëse në legjislacionin për taksën e ndërtesës.

Në rast se leja e ndërtimit e lëshuar nga organi kompetent nuk fillon të zhvillohet në afatin e parashikuar në dhënien e lejes së zhvillimit, por shtyhet pa argument të justifikueshëm për pamundësinë e zhvillimit në kohën e parashikuar në lejen e lëshuar, taksat e ndërtesës llogaritet e plotë, pavarësisht gjendjes në të cilën ndodhet ndërtesa, që nga momenti i dhënies së lejes së zhvillimit deri në momentin e fillimit të zbatimit të lejes së lëshuar.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e papunësisë nga zyra e punës
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike
- Vendimi i keshillit bashkiak për përfitimin e bonusit të qerazë (në rastin e demtimit), dhe aktet e kostatimit/vlersimit sipas rasteve.

❖ **Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat është:

Drejtoria e Tatim-Taksave Bashkia Krujë. (për ndërtesat për qëllime biznesi)

Specialistët pranë zyrave të taksave në Njësiti Administrative (për ndërtesat për qëllime banimi)

IB.TAKSA MBI TOKËN BUJQESORE.

Sipas ligjit 9632, datë 30.10.2008

Neni 23, ku thuhet baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi dhe në përdorim të taksapaguesit.

Kategoritë minimale jepen në aneksin nr.1 të këtij ligji si më poshtë:

❖ **Tabela nr6: Vlera e taksës në lekë /hektar /vit në Bashkinë Krujë.**

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës	Vlera e taksës në lekë /hektar në Vit
Kategoria I	5600
Kategoria II	4900
Kategoria III	4200
Kategoria IV	3600
Kategoria V	3000
Kategoria VI I	2400
Kategoria VI-X	1800

Keshilli bashkiak ka te drejte te aplikojte (+30%) mbi nivelin baze te taksess sipas kategorive.
Propozojme te aplikohet (-30%) per familjet qe jetojne nen minimum jetik.
Propozojme te aplikohet (-30%) per familjet, toka e te cileve permybytet nga uji, per shkak te kushteve atmosferike e daljes nga shtrati te lumenjeve.

Periashtohen nga taksa mbi token bujqesore.

-tokat qe mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari per 5 (pese) vitet e para nga casti i mbjelljes.

❖ **Struktura pergjegjese per vjeljen e taksess**

-Struktura e pergjegjese e ngarkuar per nxjerrjen e detyrimit dhe mbledhjen e te ardhurave te kesaj takse eshte Drejtoria ATAP prane Bashkise

-Struktura e pergjegjese e ngarkuar per plotesimin e faturave te arketimit te kesaj takse . eshte Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

IC. TAKSA MBI TRUALLIN

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

2. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

3. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

4. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të këtij ligji

5. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të ligjit 9632, datë 30.10.2006

6. Në rast të mungesës të dokumentacionit të pronësise, përdoruesi truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë ku ndodhet trualli.

Do te konsiderohet si siperfaqe trualli per tu taksuar cdo m2 siperfaqe (jo ndertese), qe i sherben dhe perdoret per nevojat e aktivitetit te biznesit.

Siperfaqet trualli per qellime biznesi propozojme: niveli baze i taksess rritet me (plus 30%)

Siperfaqet trualli per qellime biznesi (bujqesor/mbareshtim blektorie) propozojme: niveli baze i taksess reduktohet me (minus 20%).

Siperfaqet truall te perdorura per qellime banimi propozojme: niveli baze i taksess .

Në rast të mungesës të dokumentit të pronësise dhe refuzimit të taksapaguesit përdorues të truallit (siperfaqes jo ndertese qe perdoret per nevojat e aktivitetit biznesit), per te bere vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, për efekt taksimi nga drejtoria e taksave do të njihen të dhenat sipas proces verbalit të mbajtur nga inspektoret e terrenit në subjektin perkates.

Tabela nr7 . Niveli baze i taksës së truallit

Klasifikimi sipas Njesive	Vlera e taksës në leke /m2 /vit për qellime banimi nga individët.	Vlera e taksës në leke /m2 /vit për qellime biznesi .
Bashkia dhe Njesite Adm	0.56 Lek	20 Lek

❖ **Struktura përgjegjëse.**

DPZHKT është përgjegjëse për përcaktimin e sipërfaqes të miratuara për ndërtim dhe të parashikojë për këtë sipërfaqe aplikimin e taksës mbi Truallin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi Truallin është DTT Vendore, pranë Bashkisë Krujë.

2.TAKSA VENDORE MBI VEPRIMTARIËN E SHËRBIMIT HOTELIER

Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

- Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- Niveli tregues i taksës është sipas ligjit 142/2015 aneksi 8 bashkëlidhur këtij ligji.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo komunës, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës

❖ **Tabela nr8 Niveli i taksës së fjetjes në hotel**

Kategorite	Lek për natë fjetje
HOTELE 4-5 YJE	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së miratuar nga Bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Subjekti do të dorëzojë deklaratën përmbledhëse mujore për numrin e netëve të fjetjes në hotel gjatë muajit, për tu pajisur me faturën për arketim për të bërë pagesën në afat.

Për subjektet që nuk dorëzojnë deklaratën përmbledhëse për numrin e netëve të fjetjes në hotel, llogaritja e numrit të netëve të fjetjes në hotel, do të bëhet me 30% të numrit të dhomave gjithsej për 365 ditë në vit.

- **Mënyra e pagesës:**
Pagesa te kryhet brënda datës 5 të muajit pasardhës, sipas deklarates.
- Per subjektet qe nuk nuk dorzojne deklaraten pagesa behet sipas afatit te pageses se tarifave vendore.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet cmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

- ❖ **Struktura pergjegjese per vjeljen e takes se fjetjes ne hotel**
Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është DTT Vendore pranë Bashkisë Kruje.

4. TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.

Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të VKM 132. Date 07.03.2018, i ndryshuar me VKM nr 144 date 13.02.2020 dhe VKM 457 date 26.07.2023 aneksi 1 dhe 2, udhezimi nr 1 date 10.09.2025 për miratimin e kostos msatare të ndertimit të banesave nga EKB per vitin 2025

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:

a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individ apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 (një) deri në 3 (tre) për qind e vlerës së investimit.

b) Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c) Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit.

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblihet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Tabela nr 9: Shkallët e taksës së ndikimit në infrastrukturë për territorin e Bashkisë Krujë

Nr	Kategoritë e investimit të ri	Shkalla e taksës me VKB	Baza e taksës	Shkalla e taksës sipas Ligjit
1	Për ndërtimet e reja të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi. Për ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.	4%	Baza e taksës sipas VKM 132, date 7.3.2018, VKM 144 date 13.02.2020, VKM 457 date 26.07.2023 percaktuar ne : Aneksin 1- (Çmimet mesatare referuese te ndertesave per qellime banimi sipas qyteteve) dhe Aneksin 2-(çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtesat që nuk shërbejnë për banim)	4% - 8%
2	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit.	3%	Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, duke iu referuar kostos mesatare të ndërtimit sipas EKB.	1% - 3%
3	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë.	3%		
4	Për ndërtime individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës.	3%		
5	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë apo kategori të tjera sipas VKM nr. 283 datë 01.04.2015, e ndryshuar. Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e sportit. Objekte sportive, ambiente sportive, terrene sportive dhe mjedise sportive ku zhvillohen një ose disa sporte, në bazë të rregullave teknike, sipas përkufizimeve të legjislacionit të posaçëm sektorial.	1%		
6	Për ndërtime për qëllime publike	1%		
7	Per vendosje antenash (konstrukcion metalik)	3%		
8	Per vendosje reklamash e promocione ne rruge	3%		
9	Per rikonstruksiione me/pa ndryshim funksioni	1%		
10	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte (*)	0,1%		

II	Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi	0,5%	Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të kryer, duke iu referuar kostos mesatare të ndërtimit sipas EKB.	0,5%
----	---	------	---	------

*¹ Jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

❖ Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;

-Struktura e ngarkuar për realizimin e planit të kesaj takse, përlllogaritjen dhe lëshimin e kërkeses për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

DPKZHT përlllogarit dhe sipërfaqen e miratuar shesh ndertimi mbi të cilen do të aplikohet taksa e truallit, dhe peçjell atë pranë DTTV sebashku me kërkeses për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

-Drejtoria e Tatim taksave Vendore per proceduren e hartimit te fatures se arketimit dhe ndjekjes se pageses.

Shenim:

- Per pikat (1,2 sipas tabelës) Çmimi i shitjes për metër katror bazohet sipas VKM 132, date 7.3.2018 i ndryshuar me VKM nr 144.date13.02.2020, dhe VKM 457 date 26.07.2023, aneksin 1 dhe aneksin 2\
- Për pikën 12 sipas tabelës:Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte

Të gjitha subjektet zhvilluese/ndertuese, familjare/subjekte, do të pajisen me kërkesen për aplikim për lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Krujë vetëm pasi të kenë paguar detyrimet tatimore vendore përkatëse, taksat familjare /taksa për selinë administrative dhe për“çdo kantier ndërtimi”.

Perjashtime nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë

1-Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

2-Perjashtohen nga pagesa e kesaj takse edhe investimet e subjekteve, te cilat zhvillojne veprimtari priteze te çertifikuara si “Agroturizem”, sipas legjislacionit ne fuqi ne fushen e turizmit.

3- Perjashtohen nga pagesa e kesaj takse investimet per rindertimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuar për qëllime banimi, të dëmtuara si pasoje e fatkeqësive natyrore ,sipas perkufizimit te dhene ne legjislacionin ne fuqi e mbrojtjen civile.

Sipas VKM nr 145 date 13.02.2020. "Për kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për dhënie e lejes së ndërtimit për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, për përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë"

Për të përfituar përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë,

Për investimet që shërbejnë për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtimeve për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, së bashku me dokumentacionin përkatës që shoqëron kërkesën për dhënie e lejes së ndërtimit, investitori duhet të paraqesë edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

- a) aktin që vërteton dëmtimin e ndërtesës për shkak të fatkeqësisë natyrore;
 - b) dokumentin që përcakton shkallën e dëmtimit të ndërtesës, vlerën në lekë të dëmtimit, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe nivelin e ndërhyrjes që nevojitet në ndërtesën e dëmtuar.
- Dokumentet e mësipërme lëshohen nga autoriteti përkatës, të përcaktuara sipas procedurave të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", që bëjnë vlerësimin e dëmeve në rastin e fatkeqësisë natyrore.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;**

-Struktura e ngarkuar për realizimin e planit të kësaj takse , përlllogaritjen dhe lëshimin e kërkeses për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

DPKZHT perlllogarit dhe sipërfaqen e miratuar shesh ndërtimi mbi të cilën do të aplikohet taksa e truallit, dhe pecjell atë pranë DTTV së bashku me kërkeses për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

-Drejtoria e Tatimit taksave Vendore për procedurën e hartimit të fatures së arketimit dhe ndjekjes së pageses.

4.TAKSA E TABELËS

Mbeshtetur në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar dhe Ligjin Nr. 106/2017, datë 30.11.2017

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:

- a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla

tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabelle identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

d) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga germa të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

5. Nivelet e taksës së tabelës sipas kategorizimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, jepen në aneksin 7, bashkëlidhur këtij ligji.

6. Këshilli bashkiak është autoriteti i cili vendos nivelin e bazës së taksës për çdo kategori të tabelës të dhënë në aneksin 7, bashkëlidhur këtij ligji, si dhe miraton procedurën e mbledhjes së kësaj takse.

Tabela nr 10: Kategoritë dhe niveli i taksës jepen në tabelën e mëposhtëme

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/Matese	Vlera /leke/m2
----	-------------------	-----------	----------------

Takse tabelle per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit , ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve(ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)

a	Deri ne 2m2	Leke/m2 /ne vit	0
b	Mbi 2 m2 deri ne 10m2		
	E thjeshte pa ndricim	Leke/m2 /ne vit	10.000
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2 /ne vit	15.000
	Elektronike	Leke/m2 /ne vit	20.000
c	Mbi 10m2 deri ne 20 m2		
	E thjeshte pa ndricim	Leke/m2 /ne vit	8.500
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2 /ne vit	12.750
	Elektronike	Leke/m2 /ne vit	17.000
ç	Mbi 20m2 deri ne 40 m2		
	E thjeshte pa ndricim	Leke/m2 /ne vit	5.500
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2 /ne vit	8.250
	Elektronike	Leke/m2 /ne vit	11.000
d	Mbi 40 m2		
	E thjeshte pa ndricim	Leke/m2 /ne vit	4.000
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2 /ne vit	6.000
	Elektronike		8.000
II	Takse tabelle per qellime identifikimi, jashte territorit , ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim		
	Tabele identifikuese	Leke/m2/vit	120
III	Takse tabelle per qellime reklamimi,e levizshme dhe e palevizshme deri ne tavanin maksimal 35 m2 .		
	E thjeshte me /pa ndricim	Leke/m2 /ne vit	22.500
	Elektronike	Leke/m2 /ne vit	45.000
IV	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese,		

banderola etj.		
Te gjitha llojet dhe permasat	Leke/m2/dite	1.000

Shenim:

-Ne llogaritjen e takses per tabelat me te medha se 10m2, shumes se takses se llogaritur per siperfaqen deri ne 10m2 do ti shtohet, shuma e takses se llogaritur per diferencen e siperfaqes se mbi 10m2 te shumezuar me tarifen perkatese te takses.

- Per subjektet taksapaguese qe vendosin me shume se nje table identifikuese, vetem njera nga tabelat identifikuese do te konsiderohet si e tille, kurse tabelat e tjera do te konsiderohen si reklame.

- cdo table reklamimi qe kalon siperfaqen 35m2 do te konsiderohet sikur eshte 35m2 dhe shuma e takses llogaritet dhe paguhet vetem per kete siperfaqe pavaresisht madhesise se saj ne m2.

- Ne kategorine e reklames do te kuptojme cdo publicitet ,forme promovimi qe sherben per te njoftuar, terhequr vemendjen ose joshur blesesit ,te vendosur ne pamje joballore, ne taraca, llozhe, ballkone, ne pjese te rruges, shtylla etj qe kane permajtje me qellime reklamimi per vete ose te trete.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;**

-Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.

-Struktura e ngarkuar për identifikim e ketyre tabelave dhe vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatim-Taksave të Bashkisë Kruje.

-Struktura e ngarkuar për penalitetet për mës pajisje me leje për vendosje table reklamuese është sektori i IMT dhe Policia Bashkiake.

5. TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Bazuar në ligjin nr.68/2017 Për Finacat e Vetëqeverisjes Vendore i ndryshuar.

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni.
2. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:
 - a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
 - b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
 - c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
 - ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.
4. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

5.1 TAKSA E KALIMIT TE SE DREJTES SE PASURIVE TE PALUAJTESHME

-Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite se palujtshme vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite e palujtshme ne castin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to .

-Taksa paguhet nga personi, qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e palujtshme, para krytjes se rregjistrimit, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.

-Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit, pronesia e se ciles transferohet .

Kategorite e ndertesave per efekt te bazes se taksueshme , jepen ne aneksin nr. 3 te ligjit 9632 date 30.10.2006, " per sistemin e taksave vendore" i ndyshuar .Niveli i takses,

caktohet ne leke per meter katror te bazes se takses . Detyrimi tatimor llogaritet si shumezimi i nivelit te takses me bazen e tij.

Baza e takses se kalimit te pronesise per pasurite e tjera te palujtshme eshte vlera e shitjes se tyre. Niveli i takses caktohet ne perqindje dhe niveli tregus i takses eshte 2 per qind.

Detyrimi tatimor llogaritet si shumezimi i nivelit te takses me bazen e tij .

Tabela nr11. Nivelet e takses se kalimit te pronesise mbi ndertesat .

Kategorite e ndertesave	Vlera e takses ne lek/m ²
Ndertesat banimi	100
Ndertesat e tjera tregeti e sherbime perfshi dhe zyra.	300
Ndertesat e tjera	200

❖ Strukturat pergjegjese per vjeljet e taksës :

- **Struktura e ngarkuar per perlllogaritjen e kesaj takse eshte Agjencia shteterore e kadastraste Kruje ne cilesine e agjentit tatimor i cili perfiton 3% te shumes arketuar.**

- **Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me degen e thesarit dhe planifikimin e të ardhurave per kete takse.**

5.2 TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

-Detyrimi per pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, per çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Pergjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

-Njesite e qeverisjes vendore perfitojne 25% te te ardhurave te mblledhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura per mjetet qe jane ne territorin e saj.

-Te ardhurat e mbledhura nga taksa transferohet ne llogari te njesise se vetqeverisjes vendore deri ne fund te te muajit pasardhes.

-Ne rastet e ndryshimeve ne politiken fiskale ,qe shoqerohen me ulje te niveleve,normave dhe taksave te ndara, njesite e vetqeverisjes vendore kompensohen financiarisht,ne perputhje me nivelin e uljes se te ardhurave.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

- **Agjenti tatimor për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor e cila i perfiton 75 % e vleres se taksës se arketuar.**
- **Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me degen e thesarit dhe planifikimin e të ardhurave per kete takse.**

5.3 TAKSA E RENTES MINERARE

Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që janë të licencuar dhe veprojnë në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

•Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Njesite e qeverisjes vendore perfitojne 5% te te ardhurave te mbledhura nga renta minerare ,sipas percaktimeve te bera ne ligjin per taksat kombetare.

Te ardhurat e mbledhura nga taksa transferohet ne llogari te njesise se vetqeverisjes vendore deri ne fund te te muajit pasardhes.

Ne rastet e ndryshimeve ne politiken fiskale ,qe shoqerohen me ulje te niveleve,normave dhe taksave te ndara, njesite e vetqeverisjes vendore kompensohen financiarisht,ne perputhje me nivelin e uljes se te ardhurave.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

Në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, struktura përgjegjese per arketimin e kësaj takse është Drejtoria Rajonale Tatimore.

Në rastin e eksportit të produkteve minerare , struktura përgjegjese per arketimin e kësaj takse jane Degët e Doganave në rrethe.

Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me degen e thesarit dhe planifikimin e të ardhurave per kete takse.

5.4 TATIMI MBI TE ARDHURAT PERSONALE

Detyrimi për pagimin e tatimit i takon perfituesit te te ardhurave personale.

Njesite e qeverisjes vendore perfitojne 2% te te ardhurave te mbledhura nga tatimi mbi te ardhurat personale.

Te ardhurat e mbledhura nga tatimi transferohen ne llogari te njesise se vetqeverisjes vendore deri ne fund te te muajit pasardhes.

Ne rastet e ndryshimeve ne politiken fiskale ,qe shoqerohen me ulje te niveleve,normave dhe taksave te ndara, njesite e vetqeverisjes vendore kompensohen financiarisht,ne perputhje me nivelin e uljes se te ardhurave.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

-Agjenti tatimor për vjeljen e tatimit mbi te ardhurat personale eshte Drejtoria Rajonale Tatimore.

Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me DRT e degen e thesari dhe planifikimin e të ardhurave per kete takse.

II TARIFA VENDORE

Mbeshtetur ne nenin 35 te ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar, si dhe nenit 14 te ligjit 68/2017 "Per financat e vetqeverisjen vendore",

Njesite e qeverisjes vendore kane te drejte te vendosin tarifa per nje sherbim qe keto njesi ofrojne apo per nje te drejte qe u jepet individeve, personave fizike dhe juridike.

Ne mbeshtetje te ligjeve te siper cituar ,Bashkia krijon të ardhura nga tarifate vendore si:

I.TARIFE PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE TË FASADAVE.

1.1.Tarifa për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi

Tarifa llogaritet si detyrim mujor nga personi ndaj të cilit lind detyrimi për ta paguar një detyrim të tillë. Baza e tarifës për zënie të hapsirës publike është sipërfaqja në m², e cila përdoret nga individë dhe subjekte për qëllime të veprimtarisë së tyre, e dhene me kontratë nga Bashkia.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

Bazuar në diskrecionin e dhënë nga ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" për Bashkinë Krujë propozojmë që tarifa bazë për zënien e hapësirës publike të jetë 60 lekë/m² në muaj.

Konkretisht:

A -Tarife per zenien e hapesirave publike per qellime biznesi per siperfaqet e zena si trotuare e te tjera te ngjashme me to propozojme: niveli baze i tarifës 60 lekë/m² në muaj.

- Per cdo tavoline te vendosur ne trotuare 200 leke per tavoline /muaj

B -Tarife per zenien e hapesirave publike per qellime biznesi per siperfaqet e zena jo trotuare e te tjera te ngjashme me to propozojme: niveli baze i tarifës 60 lekë/m² në muaj.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e detyrimit, dhe procedurat që ndiqen:**

-Per piken 1.1:Drejtoria AMTP ngarkohet për përcaktimin e sipërfaqeve/hartave të parcelave objekt i kësaj tarife si dhe publikimin e tyre.
- Drejtoria Juridike hartimin e kontratave

-Drejtoria e Tatim Taksave Vendore pranë Bashkisë Kruje ngarkohet për vjeljen e taksës

➤ **Mënyrat e pagesës:**

1. Për rastin e përdorimit të hapësirave publike me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar, pagesat behen sipas përcaktimeve në kontratën e lidhur midis bashkisë dhe përdoruesit të hapësirës publike.
2. Për rastin e përdorimit të hapësirave publike me qëllim organizimin e spektakleve ose panairëve të ndryshme, pagesa bëhet me marrjen e Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, e cila jepet nga DPKZHT pranë Bashkisë.
3. Leja jepet vetëm pasi të jete vertetuar kryerja se pageses se tarifes nga personi që merr lejen.
4. Për rastin e përdorimit të hapësirave publike me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar në Tregjet Publike që administrohen nga Bashkia, tarifa është mujore dhe pagesa e saj bëhet brenda ditës së fundit të muajit përkatës pranë Bashkisë.

2.Tarifa për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik

1-Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si tubacione, kanale etj, të cilat janë ndërtuar dhe që janë në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përbalimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.

Tabela nr 12: Tarifa për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik

Nr	Tarifa për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik	Vlera lek per ml/vit
1	Per linjat ajrore	10 lek/ml/vit
2	Per linjat nentoksore	20 lek/ml/vit

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e detyrimit, dhe procedurat që ndiqen:**

Struktura e ngarkuar për dhënie leje për shtrirjen e linjave, rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse, apo të shërbimit informatik është:

-Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kruje.

Procedurat per leje fillojne bazuar në kërkesën e subjektit që do të shtrirje rrjeti, bashkengjitur projekti me gjatesine lineare te linjes qe do te shtrihet, dhe gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor.

